



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal of Kacanik

01Nr. 16-5107/14
Kaçanik, 28.02.2014

Në bazë të nenit 4.1 dhe 4.2 , 5.2 të Ligjit Nr. 03/L-087-Për Ndërmarrjet Publike, të nenit 5, 12 dhe 14 lidhur me nenin 17 Ligjit Nr. 03L-047 Për Vetëqeverisje Lokale , të nenit 34.5 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur 28.02.2014, mori këtë:

V E N D I M

**Për themelimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për KRM “Pastërtia” SH.A-
Njësia në Kaçanik**

I.

Komisioni Komunal i Aksionarëve, për Kompaninë Rajonale të Mbeturinave “Pastërtia” SH.A , përkatësisht për njësinë në Kaçanik, në përputhje me ligjet në fuqi , do t’i ketë 3 anëtarë : 1(një)anëtar i emëruar nga Kryetari i Komunës dhe dy anëtarë të tjerë të emëruar nga Kuvendi i Komunës.

II.

Përbërja e Komisionit Komunal të Aksionarëve, është:

1. Remzi Elezi, nënkryetar i Komunës,
2. Bajram Baftiu, anëtar i KK nga subjekti politik i PDK-së
3. Tahir Çaka, anëtar i KK nga subjekti politik i AAK.

III.

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e marrjes.

IV.

Për zbatimin e këtij vendimi do të përkujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emërgjencë.

V.

Me këtë Vendim do të njoftohen: Anëtarët e Komisionit komunal të Aksionarëve, Kryetari i Komunës, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë dhe përmes kësaj drejtorie njoftohet Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastërtia” SH.A-Ferizaj, dhe Arkiva.



Kryesuesi i Kuvendit,
Xhelal Gashi